



BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT TË
KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS

REHABILITIMI I STADIUMIT “SKËNDERBEU”, KORÇË

RELACION TEKNIK



Drejtori i DPPTMKI – Ark. Ndriçim Hoxha

Përgatiti – Ark. Edona Venxha

Ark. Dhimitër Këri





Tabela përmbledhëse

	HYRJE
1	OBJEKTI DHE QËLLIMI I NDËRHJRJES
1.1	Të dhënat kryesore
1.2	Objektivi
1.3	Qëllimi i punës
2	PËRSHKRIMI TIPOLOGJIK I OBJEKTIT
2.1	Përshkrimi i përgjithshëm i zonës
2.2	Historiku i objektit
2.3	Gjenda ekzistuese e objektit
2.4	Sistemi elektrik dhe i ndriçimit
3	PËRFUNDIME

1. HYRJE

1.1 Të dhënat kryesore

1. Stadiumi "Skënderbeu", Korçë.
2. Adresa: Rruga "Kristaq Papargjiri", Nr.1, Lagjia 10, Korçë
3. Nën njësia KO/UB364 Sistemi UB. Urban
4. Kategoria: AR. Aktivitete Sociale dhe Rekreacion
5. Nr. i kateve mbi tokë – 2

1.2 Objektivi

Objekti i këtij projekti konsiston në rehabilitimin e godinës së Tribunës ekzistuese përmes ndërhyrjeve në mbulesë, ambiente të brendshme, sistemet hiodraulike dhe të ngrohjes, si dhe në stolat e stadiumit.

Qëllimi kryesor i ndërhyrjes është eliminimi i dëmtimeve të akumuluar nga amortizimi natyror dhe faktorët atmosferikë, përmirësimi i performancës të godinës, eliminimi i problemeve të lagështisë dhe infiltrimeve nga mbulesa. Projekti synon gjithashtu uljen e kostove të mirëmbajtjes në të ardhmen dhe përmirësimin e cilësisë së mjediseve të brendshme.

1.3 Qëllimi i punës

Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin po ashtu të kryejë vizitë në vend për bërë një analizë më të detajuar rreth gjëndjes. Të kryejë testime të objektit në zonat kyçe problematike që mund të evidentohen

për të plotësuar si hartimin e projektit. Cilësia e studim projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar dhe të plotësojë kushtet Normativat dhe Rregulloret e projektimit në fuqi.

2. PËRSHKRIMI TIPOLOGJIK I OBJEKTIT

2.1 Përshkrimi i përgjithshëm i zonës

Korça është qyteti më i madh që ndodhet në juglindje të vendit. Korça ndodhet në lartësinë 850 metra mbi nivelin e detit. Ndërtesa është në një zonë banimi me dendësi të lartë të popullsisë. Kodi i njësisë është KO/UB364. Kategoria është “Aktivitete Sociale dhe Rekreacion”.




Figure 1 - Pjesë nga PPV i Stadiumit "Skënderbeu"– Korçë lidhja me qendrën e qytetit

Të dhënat e zonës klimatike

Korça shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë. Klima është e tipit kontinental lokal, me temperature mesatare vjetore prej 11.4°C. Temperaturat mesatare mujore arrijnë afërsisht 21.2°C në Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrijnë në gusht me 34. 4°C. Temperatura mesatare më e ulët është në Janar rreth 1.5°C me një minimum prej -17.5°C. Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që territori i Korçës të futet në zonën ku dimri është i ftohtë dhe vera është e freskët.

2.2 Historiku i objektit

Stadiumi "Skënderbeu" në qytetin e Korçës është një nga impiantet sportive më të rëndësishme dhe më me traditë në Shqipëri. Ai u ndërtua dhe u inaugurua në vitin 1957, duke u bërë që prej asaj kohe shtëpia e Klubit të Futbollit "Skënderbeu" dhe qendra kryesore e zhvillimit të aktiviteteve sportive në qytet. Fillimisht stadiumi kishte një kapacitet prej rreth 12 000 spektatorësh, me tribuna të ulëta në formë ovale dhe një tribunë kryesore modeste, tipike për arkitekturën sportive të periudhës së viteve 1950. Gjatë dekadave stadiumi ka pritur ndeshje të kampionatit kombëtar, Kupës së Shqipërisë, si dhe aktivitete atletike e sportive me karakter lokal dhe kombëtar.



Figure 2 - Pamje ajrore e Stadiumit "Skënderbeu"

Tribuna kryesore përbën elementin më përfaqësues të stadiumit, pasi ka qenë gjithmonë pjesa ku janë vendosur ambientet administrative, dhomat e zhveshjes, hapësirat për arbitrat, gazetarët dhe tribunat VIP. Edhe pse struktura bazë e saj i përket ndërtimit origjinal të vitit 1957, ajo ka kaluar ndërhyrje të ndryshme mirëmbajtjeje dhe modernizimi ndër vite, duke ruajtur funksionin e saj si qendra organizative e stadiumit. Në vitet 2010–2011 stadiumi iu nënshtrua një rikonstruksioni të plotë, ku edhe tribuna kryesore u modernizua sipas standardeve të UEFA-s, me përmirësimin e ambienteve të brendshme, vendosjen e ulëseve individuale, sistemeve të reja teknike dhe infrastrukturës për median. Pas këtij investimi, stadiumi u licencua për zhvillimin e ndeshjeve të raundeve paraprake të kompeticioneve evropiane, duke shënuar një etapë të rëndësishme në historinë e tij.



Figure 3 - Punimet e restaurimit, viti 2011



Figure 4 - Punimet e restaurimit, viti 2011

Sot, tribuna kryesore e Stadiumit "Skënderbeu" përfaqëson jo vetëm një element funksional të implantit sportiv, por edhe një pjesë të trashëgimisë sportive të qytetit të Korçës, duke dëshmuar zhvillimin e futbollit korçar dhe transformimin e një stadiumi historik në një implant bashkëkohor.

2.3 Gjenda ekzistuese e objektit

Objekti është me 2 kate mbi tokë. Sipërfaqja katit përdhe (ku ndodhen dhomat e zhveshjes, tualetet, dushet, dhoma e arbitrit etj.) është ~ 475 m², e katit të parë (ku ndodhen ambientet e brendshme të Tribunës VIP, Gold A dhe Gold B) është ~ 195 m². Ndërtesa përbëhet nga ambiente të ndryshme si zyra, magazina, dhomat e zhveshjes, dushe, tualete, ambiente ndihmëse të kaldajës etj. Në rikonstruksionin e saj do të ndërhyhet edhe në rehabilitimin e funksioneve parësore dhe adaptimin e tyre me rregulloret e standartet bashkohore. Në tërësinë e tij, objekti nuk ka nevojë për ndërhyrje në structure, por ka nevojë ndërhyrjeje në sistemet teknike, një pjesë e të cilave nga këto të fundit nuk funksionojnë në rregull.

Godina objekt rehabilitimi është ndërtim ekzistues me sistem konstruktiv B/A, mure ndarëse tulle dhe tarracë. Organizimi funksional përbëhet nga ambiente të destinuara për përdorim publik të shpërndara sipas konfigurimit ekzistues të planimetrisë.



Figure 5 - Pamje e Tribunës VIP

Struktura mbajtëse rezulton në gjendje të qëndrueshme dhe nuk paraqet deformime ose dëmtime që kërkojnë ndërhyrje strukturore. Problematikat kryesore lidhen me elementët e mbulesës, përfundimet arkitektonike, izolimet dhe amortizimin e materialeve përfundimtare. Karakteristikat arkitektonike të godinave do të ruhen, ndërsa ndërhyrjet do të përqendrohen në përmirësimin teknik dhe funksional të elementëve ekzistues.

Për shkak të faktit se ky objekt ka pasur ndërhyrjet e fundit të restautimit në vitin 2010-2011, disa elementë të tij, kanë pësuar amortizim nga koha, faktorët atmosferikë dhe përdorimi i vazhdueshëm dhe i pandërprerë.

Përveç sa më sipër gjendja e përgjithshme ka dhe probleme të tjera si:

1. Lagështia - në brëndësi të objektit vjen nga tarraca e cila ka zona ku ka infiltrime pasi nuk ka izolim. Vetëm një pjesë e tarracës rezulton të ketë izolim, por edhe pjesët ku izolimi është prezent, kanë infiltrime të rreshjeve si shkak i amortizimit. Elementët kryesore që paraqesin problematika, janë pjesa qendrore e tarracës që nuk ka izolim, impjuvet e llamarinës të cilat janë shkëputur, deformuar ose mungojnë, ullukët vertikalë dhe horizontalë prej material PVC, që kanë pësuar çarje dhe kontribuojnë në shtimin e lagështisë në ambientet e brendshme.
2. Muret e jashtme dhe fasada - Pamja e mureve të jashtme janë relativisht e mirë dhe e mirëmbajtur. Në disa mure perimetrale, të fasadës perëndimore, kemi infiltrime të lagështisë që vjen si pasojë e lagështisë që vjen nga amortizimi i elementëve të lartpërmendur. Duke zgjidhur çështjen e lagështisë, edhe këto mure do të rikthehen në funksionin e tyre optimal.
3. Tualetet - janë në gjendje të mire, por ka gjithmonë nevojë për zëvendësime të elementëve të veçuar që kanë humbur funksionin e tyre si pasojë e përdorimit dhe kalimit të kohës. Ndërhyrjet do të jenë si në rehabilitimin e tualeteve ekzistuese, si edhe në krijimin e një tualeti të ri.
4. Dyert dhe dritaret e jashme - Nga konstatimi i bërë në vend kemi vënë re se dritaret e jashtme janë të gjitha me duralumin. Janë në gjendje të mirë dhe nuk ka nevojë për zëvendësime.
5. Dyert e brendshme – Dyert kryesore e ndërtesës janë tamburato të rimesuara, e cila për nga cilësia dhe pamja është brenda standarteve për një ambient bashkëkohor. Gjithsesi ka nevojë për ndërhyrje të vogla në zëvendësimin e bravave të dyerve si shkak i përdorimit të vazhdueshëm.
6. Sistemi i ngrohjes së ujit – Sistemi i ngrohjes së ujit për ekipet e futbollit (vendat dhe mik) është vendosur në restaurimin e fundit që ndodhi në vitet 2010-2011. Duke qënë se ka kaluar një periudhë 15 vjeçare nga përdorimi i parë, ky sistem prezanton defekte të ndryshme. Ena bafer dhe sistemi i tubacioneve, paraqesin rrjedhje dhe kanë nevojë për zëvendësime. Ky sistem është jetik për stadiumin sepse përdoret çdo ditë nga stafi, arbitrat dhe lojtarët e të dyja skuadrave.
7. Elementë të tjerë – Stadiumi ka nevojë për zëvendësimin e stolave të cilat me kalimin e kohës janë thyer ose dëmtuar. Gjithashtu edhe postacioni i kameramanit mbi tarracën e tribunes ka nevojë për një mbulesë.

2.4 Sistemi elektrik, ndriçimi dhe ngrohja

Ky sistem është në gjendje të mirë, përmbush normat e kërkuara dhe ka nevojë vetëm për disa zëvendësime të elementëve të veçantë. Ka nevojë për të bërë instalime të reja shtesë në ambientet e tualetit të ri që do të krijohet. Sistemi i ngrohjes është në gjendje të mirë, ai bëhet me anë të kondicionerëve dhe nuk ka nevojë për ndërhyrje.



Figure 6 - Pamje e izolimit të tarracës



Figure 7 - Pamje e ambienteve të brendshme, dhoma e shtypit




Figure 8 - Impianti i amortizuar i ngrohjes së ujit




Figure 9 - Ullukët e dëmtuar



Figure 10 - Ambientet e dusheve të skuadrës mike



Figure 11 - Ulluku vertikal i dëmtuar

Punimet kryesore që do të kryhen:

- Ndërtimi i një tualeti të ri në Tribunën VIP
- Hidroizolimi i tarracës, duke përfshirë dhe ullukët vertikalë, horizontalë
- Instalimi i një impianti të ri për ngrohjen e ujit (sistem me kaldajë, enë buffer etj)
- Zëvendësimi i stolave të stadiumit të dëmtuar ose që mungojnë
- Zëvendësimi i dusheve në dhomat e zhveshjes
- Punime të tjera mirëmbajtjeje si lysterje etj.

3. PËRFUNDIME

Ndërhyrja dhe investimi në këtë godinë janë jetike për të garantuar sigurinë e jetës, shëndetin dhe kushtet minimale të dinjitetshme për stafin dhe lojtarët. Pa këtë projekt, ndërtesa mbetet e ekspozuar ndaj rreziqeve serioze, si mungesa e një tarrace funksionale, infiltrimet e lagështisë, të cilat së bashku me mungesën e sistemit të ngrohjes së ujit e bëjnë objektin jo eficient. Për më tepër, investimi rregullon parametrat izolimit, duke eliminuar përfundimisht të ftohtin e ashpër të Korçës, lagështinë, mykun dhe ndotjen që vjen nga sistemi i amortizuar i ngrohjes së ujit. Ky rikonstruksion e shndërron godinën në një mjedis bashkëkohor, eficient dhe plotësisht të sigurt sipas standardeve të kohës.

Drejtori i DPPTMKI - Ark. Ndriçim Hoxha

Ark. Edona Venxha

Ark. Dhimitër Këri